



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prinjevoj / Predato Received / Delivered	31.12.2021	1	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Rjeshta Org / Rjesht	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPRISHCK	6479/2021		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1006/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malësore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1006/2021 të datës 06.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "B-Bahri Fazliu", PN, Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1006/2021 e datës 06.12.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoli 9/2021 i datës 22.11.2021 i Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 06.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5812/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 9/2021 të datës 22.11.2021 të Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr 26/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil si dhe shkeljeve procedurale të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.12.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ndërsa me datë 14.12.2021, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.1006/2021 të datës 06.12.2021; Vendimin me numër protokoll 9/2021 të datës 22.11.2021 të Udhëheqëses së Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Vendimin me numër protokoll 21/2021 të datës 15.11.20,, Konkursin me numër reference RN000076618 të datës 16.09.2021; Diplomën me numër 515/0716 të datës 18.07.2016; Diplomën me numër 52/09 të datës 27.07.2009; Njoftimin e datës 15.11.2021 për shpalljen e Listës së ngushtë; emailin e datës 13.12.2021 nga Arkiva e MPB për R.K; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 1393 të datës 13.12.2021; Ankesën e datës 17.11.2021; Aplikacionin e ankuesit me Nr.reference RN00007618 të datës 29.10.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për _____ për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për _____ për vitin 2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për _____ për vitin 2019; Vërtetimin me numër reference 783 të datës 28.10.2021; Certifikatën nen hetime të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 25.10.2021; Letër Motivimi për ankuesin e datës 28.10.2021, Reference nga B&S Evropë të datës 03.07.2015; Vendimin me nr.1535/2021 të datës 04.06.2021; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit të datës 31.10.2016; Vendimin me nr.reference 03/03 të datës 27.01.2016, Certifikatën për ndjekje te trajnimit të lëshuar nga CRPK dhe UNCHR, Certifikatën për ndjekje të trajnimit të lëshuar nga IKAP nëntor 2014, Certifikatën e lëshuar për ankuesin nga IKAP trajner i IKAP-it, Certifikatën për ndjekje te Workshopit nga data 13-17 maj 2019 nga Ambasada Amerikane në Kosovë, Certifikatën për Pjesëmarrje ne Forumin e organizuar nga NCCH me datë 16.10.2019, Certifikatën për Kodin e Etikës datë 14.12.2012; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 02.09.2009, për Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 21.09.2008 për ankuesin, Përgjigje në ankesë me numër protokoll 6092/2021 të datës 14.12.2021,

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit _____ është e pa bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se organi i punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 16.09.2021 ka shpallur konkursin e hapur me Nr.Ref.RN00007618, për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, nivel i lartë drejtues 2, e në të cilën pozitë ka aplikuar edhe ankuesi.

Për këtë pozitë të punës, me datë 29.10.2021, ankuesi ka dorëzuar aplikacionin me numër Kodi RAN0001263 se bashku me dëshmitë për aplikim, mirëpo Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në fazën e verifikimit të dokumentacionit, ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 21/2021 të datës 15.11.02021, përmes të cilit ka refuzuar aplikacionin e ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmi të diplomës së studimeve themelore me 240 kredi si

dhe kopjen e Letërnjoftimit ashtu siç cekët në konkurs, e në këtë mënyrë ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë.

I pakënaqur me vendimin mbi refuzimin e aplikacionit, ankuesi me datë 17.11.2021 ka parashtruar ankesë në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ky i fundit, me datë 22.11.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoll 9/2021, përmes të cilit ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit. Kundër këtij vendimi, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të: vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 26/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe shkeljeve procedurale të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Me tutje ankuesi shton se ka plotësuar kushtet sipas konkursit sepse posedon diplomë universitare në fushën e drejtësisë dhe se vendimi i kontestuar me ankesë është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit Nr.015/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që i njëjti organ ka refuzuar aplikacionin e tij dhe ka vendosur lidhur me ankesën kundër refuzimit të aplikacionit. Propozon që të aprovohet ankesa, të anulohet konkursi i datës 16.09.2021 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në IKAP, ose ankuesit t'i mundësohet vazhdimi i mëtejshëm në konkursin në fjalë.

Organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit me Nr.Ref. RN00007618, për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, ka përcaktuar kushtet e përgjithshme formale, si në vijim:

- *Diplomë të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS, fushat e shkollimit: administratë publike, menaxhment publik, shkenca politike ose drejtësi dhe*
- *se paku (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë në pozita udhëheqëse.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të ankuesit dhe si rrjedhojë ka gjetur se ankuesi sipas Diplomës me numër 52/09 të datës 27.07.2009 të lëshuar nga Universiteti Privat "Daradnia", ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik dhe ka marrë titullin Bachelor i Kriminalistikës me gjithsej 180 kredi/ECTS, ndërsa sipas Diplomës me numër 515/0716 të datës 18.07.2016 të lëshuar nga Kolegji "Fama", ankuesi ka përfunduar studimet master në Programin e Studimeve të Shkencave të Sigurisë dhe ka marrë gradën "Master i Arteve në Studimin e Shkencave të Sigurisë", kështu që Kolegji vlerëson se ankuesi nuk ka përmbushur kriterin e arsimimit sepse i njëjti posedon diplomë të studimeve bachelor me gjithsej 180 kredi/ECTS, ndërsa fusha e studimeve master nuk është vazhdim i fushës së studimeve themelore, e mbi këtë bazë rezulton se është i pa bazuar pretendimi ankimor i ankuesit se i njëjti ka plotësuar kriteret e konkursit.

Po ashtu, Kolegji konstaton se është i pa bazuar pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me faktin se është bërë shkelje e parimeve të procedurës së përgjithshme administrative pasi që organi i njëjtë ka vendosur për refuzimin e aplikacionit të ankuesit dhe për ankesën e tij të ushtruar kundër vendimit për refuzim të aplikacionit, sepse, në mbështetje të nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 8 të Rregullores (QRK)-Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtuese, Njësi

përgjegjëse për organizimin e procedurës së konkurrimit për pozitat e kategorisë së lartë drejtuese për institucionet e administratës shtetërore është Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa, duke ju referuar dispozitave të Rregullores (ZKM) Nr.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Kolegji ka gjetur se Divizioni i Zhvillimit të Rekrutimit dhe Inspektimit si njësi organizative në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, është përcaktuar si organ përgjegjës për organizimin e procedurave të rekrutimit për pozitat e nivelit të lartë drejtues në institucionet e administratës shtetërore.

Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji vlerëson se Divizioni i Zhvillimit të Rekrutimit dhe Inspektimit në Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll 9/2021 të datës 22.11.2021, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar kështu në përputhje me nenin 40 paragrafi 5 nënparagrafi 5.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 8 të Rregullores NR.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kështu që Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente,/Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1006/2021

Rushit Kajtazi
Rushit Kajtazi
Proçesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi
Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.